



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 93 prot.

Kamëz, më 18.7 .2021

V E N D I M

Nr. 77 .Datë 19/2 2021

MBI

“TRAJTIMIN ME SUBVENCIONIN E QIRASË TË DISA FAMILJEVE NË NEVOJË QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 19.07.2021 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim Projekt –Vendim Nr.66 Datë 13.07.2021 në mbështetje të nenit 113, pika 2, të kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”, Vendimit nr.301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit”, Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, Vendimit nr.65 datë 25.06.2020, të Këshillit Bashkiak “Për ngritjen e Komisionit të Strehimit”, Vendimit nr.152 datë 18.12.2020 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë për Bashkinë Kamëz për familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë”, Vendimit nr 160 dt.23.12.2020 për “ Miratimin e detajimit të buxhetit të vitit 2021,2022,2023”, si dhe bazuar në vendimin e marrë nga Komisioni i Strehimit, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I :

1. Të miratojë trajtimin me subvencionin e qirasë për individët/ familjet, sipas listës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për individët/familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë për një periudhë 6 mujore, duke filluar nga data 01.07.2021 deri më datë 31.12.2021.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga pika “1”, në shumën prej **1,093,542 (një milion e nëntëdhjetë e tremijë e pesëqind e dyzetë e dy) lek** ,për periudhën Korrik-Dhjetor 2021, do të përballohen 100% nga nga buxheti i Bashkisë Kamëz sipas **Prog 06180 Art 606**
4. Bashkëngjitur këtij vendimi gjendet lista e familjeve përfituese (tab.nr.3).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

5. Të ngarkojë Drejtorinë e Finances dhe Kontabilitetit, Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Nën/ Kryetar Këshilli
Ali Dauti

